



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 27 Prot.

Tiranë, më datë 17.01.2025

VENDIM
Nr. 24, datë 17.01.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sqj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.01.2025:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Restaurimi dhe përshtatje interieri pa ndryshim fasade, vëllimi dhe sipërfaqe, i ish banesës së Z. Lili Vrusho në pronësi të Znj. Serena Pajo dhe Z. Anduen Pajo M-013, lagjja Mangalem, Berat”, Monument Kulture i Kategorisë së II-të, me aplikues dhe zhvillues **Znj. Serena Pajo**;
2. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren në mënyrë të vazhdueshme nga DRTK Berat sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

